armiq të këqij që në syt të çfaqen si miq prej të cilvet u ndruaj që të mbarohet dëshira. Ka edhe shum njerës që ty të bijnë më qafë me hile e me çpifje, po i Madhi ZOT ty të mpron dhe çdo gjë t'a dorëzon prapë e të përgëzon prapë tue të qitë faqe bardhë për jetë.

38) Xh.B.B. = O bilbil i fatit! Ti je mbrënda në qëllim të mbarë. Mos u idhno se ç'do punë që të punojsh të kthehet për hajir. I Madhi ZOT (xhel-le shanuhu) ty do të falë evlád të hajirit dhe do të gëzohesh me të mira. Armiqët t'uej do të dërmohen. Do të vijë rizk nga s' pandehet edhe dëshira të mbarohet. Duket se ke edhe një udhëtim të hajirit (inshaell-llah).

39) Xh.D.D. = O bilbil i fatit! Ky fat ashtu shënon se do të bëjsh miqësi me një njeri që ësht shpirt mirë dhe me tregëti do të shohish shum hajir dhe i Madhi ZOT (xhel-le xhelaluh) do t'i mbarojë të gjith dëshirat e do të shpëtojë nga gjith armiqët.

40) B.D.D. = O bilbil i Fatit! Ky qëllim që ke ësht dritë dhe nga hidhrimi ke shpëtim për jetë. Porta e këtij qëllimi sot ësht e mbyll po i Madhi ZOT do t'a çelë dhe dëshirën do t'a falë. Ke edhe një udhtim të hajirit.

41) Xh.A.D. = O bilbil fatmir! Shum njerës nakarës duan t'a ndalin fatin tënt, po fati ësht me ty. Myzhde të qoftë se ti dëshirën do t'a qafojsh. Dëshira e jote sikur në fund të detit të jét do të

mbarohet, i Madhi ZOT dëshirën t'ënde do t'a plotësojë në të dy jetë (inshaell-llah).

42) Xh.A.Xh. = O bilbil i fatit! Ti do të kalojsh pak hidhrim po prap ke shpëtim. Ti shëmbllen si Lajmëtar Hazreti Jusufi, të cilin i Madhi ZOT nga pusi që e hodhë nakarsija e shpëtoj dhe së fundi e naltësoj si mbret. Ashtu edhe ti nga armiqët do të shpëtosh dhe do të urdhrosh mbi ta për jetë me fjalë të vërteta, duket se ke edhe udhtim hajir tue qafue gjith dëshirat (inshaell-llahu teala).

43) Xh.B.Xh. = O bilbil fat kandil! Ka shum njerës që nuk t'a duan fatin t'ënd po fatin e ke shok edhe shpëton nga gjith trokët. I Madhi ZOT kurdoherë ty të ndihmon dhe armiqët t'uej i dërmon dhe i turpëron sheshit. Duket se ke edhe një udhtim hajir tue qafue të gjith të [illegible] (inshaell-llehu teala).

44) Xh.D.Xh. = O bilbil fat trëndafil! Të ndritet syri edhe fati! I Madhi ZOT (Xh.Xh.) nga punrat hajir që ke bërë ty të fali sevapin e një Haxhillëku të pranuar edhe do të çelë një portë me të mira sa të mbetesh fort i gëzuar me këshilat kuranore. Ti vehten e mban në dyshim, por përjashtoje. Atë qëllim që ké e ké hajir edhe do të shohish shumë të mira (inshaell-llahu teale).

45) Xh.D.B. = O bilbil! Ti ke një udhtim me fitim e mbaskëndaj nuk sheh hidhrim e pengime kurrë. Ka njerës që të kundërshtojnë po ti me ta mos u bëj shok po shiko punën, se ti nga s' pandeh do